



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Polican

Nr. _____ Prot

Data 07.11.2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës- Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Asfaltimin e Rrugës Tërpan- Teman, Njësia Administrative Tërpan”,
Bashkia Poliçan.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Sinjalistikë rrugore 34992200-9
- Struktura betoni të përforcuara 45223500-1
- punime rrugore 45233140-2
- Punime shtrimi dhe asfaltimi 45233222-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 67 664 493 (gjashtedhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e katër mijë e katërqind e nentëdhjetë e tre) lekë pa tvsh Monedha, paTVSH

Fondi i përlogaritur për vitin buxhetor 2025 është : 33 161 940 (tridhjetë e tre milion e njëqind e gjashtedhjetë e një mijë e nentëqind e dyzete) lekë pa TVSH, nga te cilat financuar nga Keshilli i Qarkut ne buxhetin e bashkise ne vleren 24 383 779(njezete e kater milion e treqind e tetedhjetë e tre mijë e shtateqind e shtatedhjetë e nente) leke pa tvsh dhe nga buxheti i bashkise Polican ne vleren 8 778 161(tete milion e shtateqind e shtatedhjetë e tete mijë e njëqind e gjashtedhjetë e një)leke pa tvsh.

Fondi i përlogaritur për vitin buxhetor 2026 është: 19 669 582 (nentembedhjetë milion e milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nente mijë e pesëqind e tetedhjetë e dy) lekë pa TVSH, nga te cilat financuar nga Keshilli i Qarkut ne buxhetin e bashkise ne vleren 4 063 963(kater milion e gjashtedhjetë e tre mijë e nentëqind e gjashtedhjetë e tre) leke pa tvsh dhe nga buxheti I bashkise Polican ne vleren 15 605 619(pesembedhjetë milion e gjashtëqind e pese mijë e gjashtëqind e nentembedhjetë) leke pa tvsh.

Fondi i përlogaritur për vitin buxhetor 2027 është: 14 832 971 (katëmbëdhjetë milion e teteqind e tridhjetë e dy mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e një) lekë pa TVSH, nga të cilat financiar Keshilli i Qarkut në buxhetin e bashkise në vlerën 5 386 348 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzete e tete) leke pa tvsh dhe nga buxheti I bashkise Polican në vlerën 9 446 623 (nente milion e katërqind e dyzete e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzete e tre) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin 16/2024 nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor **Bashkia e Poliçan** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1 KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar

Nëse gjuha përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 76, dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 3, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar, citojmë Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të pergjithshme dhe të vecanta të kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të nenit 3 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

Vendosja e ketyre kritereve behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK .

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur dhe konfirmuara nga Autoriteti tatimor perkates si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat

zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, etj

2.2.3 Operoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas adreses kryesore dhe dytesore të shënuar në QKB sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të OE, çdo anëtar i grupit BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse, për vitin vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (Sipas QKB).

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesi dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar si dhe Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 OE, duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesë:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (konkretisht 33 832 246.5 tridhjetë e tre milion e teteqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e dyzete e gjashtë pike pese leke pa tvsh) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , në një vlerë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht 135 328 986 (njqind e tridhjetë e pese milion e treqind e njezete e tete mijë e nenteqind e tetedhjetë e gjashtë lek) pa tvsh.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të OE do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
5. Akt Kolaudimi
6. Certifikaten e Marrjes ne dorezim te punimeve

Në rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

b) Operatori Ekonomik, si dëshmi të përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë:

1. Kontratën/Kontratat;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Faturat tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
4. Akt Kolaudimi
5. Certifikaten e Marrjes ne dorezim te punimeve

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve, shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatorëve, dhe prokuren .

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin 16/2024, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion , tipologjinë e punimeve të ndërtimit si edhe mbështetur në LPP dhe në RRPP. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon dokumentacionin si më sipër.

2.3.2 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI :

- **NP-1 A** Punime gjurmimi në tokë.
- **NP-4 C** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.
- **NP-5 A** Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
- **NP-12 B** Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT:

- **NS-6 A** Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- **NS-18 B** Punime topogjeodezike.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 ; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, autoriteti kontraktor argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas projektit të zbatimit dhe sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas projektit sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

- Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Detajini i kërkeses se cdo license sipas punimeve qe do te kryhen:

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.

	I - Shtresat rrugore		
3.212/b	Shtresë stabilizant t=10 cm	m2	20,772.00

NP-4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale.

	II - Shtresat asfaltike		
3.222/1	Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri	m2	20,772.00
3.224/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	m2	20,772.00

NP-5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

	IV - Punime Betoni		
2.166/1a	FV hekur betoni periodik fi > 12 mm	ton	2.00
1.127/p	Bordura betoni 20x35 cm	ml	450.00
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	84.8
2.262/4	Shtresë betoni C 16/20	m3	30.00
3.365	Tombino me tuba betoni fi 600, mbi shtresë betoni	ml	15.00

NP-12 B Punime të inxhinierisë mjedisore

Te gjitha punimet kane ndikim te larte ne mjedis pasi punimet kryhen vargamalit te terpanit ne te cili ka bimesi te ndryshme.

	II - Shtresat asfaltike		
3.222/1	Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri	m2	20,772.00
3.224/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	m2	20,772.00

PUNIME SPECIALE NDERTIMI**NS-6 A Sinjalistika rrugore jondriçuese.**

	III – Sinjalistika		
3.942	Vijëzim shirita gjatësorë dhe anësor me gjerësi 12 cm, Bikoponente (sprajt)	ml	10,100.00
3.936/1	Tabela trekëndore normal me A = 90	copë	10.00
3.955	FV tabela të ndryshme rrugore D = 60 cm	copë	7.00
An91	Panele plotësues i sinjalistikës rrethore normal 50 x 25	m2	4.00
An59	Sinjale "emër rrugë" LxH normal 80x25	m2	4.00
An1	Guarrdrail - N2 anësore me 2 valëz. Në 1 anë, E2 + aksesorë	ml	85.00

NS-18 C Punime topogjeodezike.

Ndertimi i kesaj rruge kerkon nje topografi te mirefillt pasi ne te gjitha shtresat dhe punimet e permendura me poshte duhet topografimi ne cdo faze te shtresave dhe cdo distance te prerjeve terthore duke ruajtur kuotat ne projekt.

	I - Shtresat rrugore		
3.212/b	Shtresë stabilizant t=10 cm	m2	20,772.00

	II - Shtresat asfaltike		
3.222/1	Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri	m2	20,772.00
3.224/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	m2	20,772.00

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjërmimi në tokë	3.212/b -Shtresë stabilizant t=10 cm	A (0–20milion lekë)	
NP –4	Rrugë,autostrada, mbikalime,hekurdha,tramvaj,metro,pista aeroportuale.	- Shtresat asfaltike 3.222/1 - Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri 3.224/1- Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	C (51—100milion lekë)	
NP-5	Punime nën tokësore, ura e vepra arti.	IV - Punime Betoni 2.166/1a -FV hekur betoni periodik fi > 12 mm. 1.127/p Bordura betoni 20x35 c. 3.244- Struktura monolite betoni C 20/25m 2.262/4 -Shtresë betoni C 16/20 3.365 -Tombino me tuba betoni fi 600, mbi shtresë beton.	A (0–20milion lekë)	
NP-12	Punime të inxhinierisë mjedisore	- Shtresat asfaltike 3.222/1-Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri 3.224/1- Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	B(21–50milion lekë)	
NS –6	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.	- Sinjalistika 3.942-Vijëzim shirita gjatësorë dhe anësor me gjerësi 12 cm, 3.936/1 -Tabela trekëndore normal me A = 90 3.955-FV tabela të ndryshme rrugore D = 60 cm An91-Panele plotësues i sinjalistikës rrethore normal 50 x 25	A (0–20milion lekë)	

		An59-Sinjale "emër rruge" LxH normal 80x25 An1-Guarrdrail - N2 anësore me 2 valëz. Në 1 anë, E2 + aksesore		
NS – 18	Punime topogjeodezike	- Shtresat rrugore 3.212/b -Shtresë stabilizant t=10 cm - Shtresat asfaltike 3.222/1-Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri 3.224/1-Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	B(21–50milion lekë)	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën **30** (tridhjetë) persona , të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e tre muajt e fundit te deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit .

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Mbeshtetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, afati i realizimit te kontrates, orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per te pakten tre muajit e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Numri i punonjësve qe nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatmi te tij.

2.3.4 Operatorët Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

a. Inxhinier Ndërtimi Infrastruktura/Rruge ura/Transport	1 (nje)
b. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
c. Inxhinier Gjeodet	2 (dy)

Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte:

- Kontratë pune e vlefshme,
- Diploma Universitare
- si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin teknik inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në bazë të vlerësimit të grafikut të punimeve., analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit si me poshte:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** Infrastruktura/Rruge ura/Transport është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punime vetë parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-1A, NP-4A, NS-6A, NS-18B, si dhe është e nevojshme prezenca e tij si person përgjegjës për ndjekjen e punimeve te ndërtimit pasi siguron që ato të kryhen sipas standardeve dhe projekteve të miratuara. Inxhinieri i Ndërtimit, është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit, stabilizantit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder .
- **Inxhinieri Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NS-18B. Eshte e nevojshme prezenca e tij , pasi përcakton dhe monitoron matjet e terrenit dhe siguron saktësinë e punimeve topogjeodezike dhe çdo matje, pozicionim, rakordim në vendosje sipas plan-vendosjes që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit, me qëllim realizimin e rlevimeve topografike të domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Inxhinier Mjedisi** është i domosdoshëm për menaxhimin e mbetjeve , të ndotjeve, të ajrit, të zhurmave si dhe mbikëqyr zbatimin e masave të mbrojtjes mjedisore referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-12B.

2.3.5Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

• Teknik ndertimi	1 (nje)
• Teknik Topograf	1 (nje)
• Karpentier	2 (dy)
• Murator	2 (dy)
• Specialist per punime asfalti	8 (tete)

- Automakinistë 2 (dy)
- Manovrator 3 (tre)
- Buldozieristë 1 (nje)
- Puntori e thjeshte 3 (tre)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetës për kryerjen e punimeve, të vertetuar me

- kontratë punë të vlefshme,
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Për Tekniket duhet të paraqitet deftese e shkolles së mesme .
- si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për Manovrator/automakiniste/shofer të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR . Në rastin kur punonjësit e mesipër janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira , nuk kërkohej të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Dokumentacioni (Diplomat/deshmited/certifikatat) që nuk është lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontratë të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e data e zhvillimit të tenderit, shoqëruar me dokumentacionin, Librezë pune; Kontratë pune të vlefshme; Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik dhe stafin mbeshtetes të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Nr.	AN.	ZËRAT E PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ORË PUNE / NJËSI	ORË PUNE TOTAL	DITË PUNE
		I - Shtresat rrugore					
1	3.212/b	Shtresë stabilizant t=10 cm	m ²	20,772.00	0.075	1557.9	195
Shuma Ditë Pune I							195
		II - Shtresat asfaltike					
2	3.222/1	Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri	m ²	20,772.00	0.109	2,264	283
3	3.224/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri	m ²	20,772.00	0.082	1,703	213
Shuma Ditë Pune II							496
		III - Sinjalistika					
4	3.942	Vijëzim shirita gjatësorë dhe anësor me gjerësi 12 cm, Bikoponente (sprajt)	ml	10,100.00	0.10	1,010	126
5	3.936/1	Tabela trekëndore normal me A = 90	copë	10.00	0.50	5	0.63
6	3.955	FV tabela të ndryshme rrugore D = 60 cm	copë	7.00	0.50	4	0.44
7	An91	Panele plotësues i sinjalistikës rrethore normal 50 x 25	m ²	4.00	0.30	1	0.15
8	An59	Sinjale "emër rruge" LxH normal 80x25	m ²	4.00	0.50	2	0.25
9	An1	Guarrdrail - N2 anësore me 2 valëz. Në 1 anë, Ë2 + aksesorë	ml	85.00	1.74	148	18.49
Shuma Ditë Pune III							146
		IV - Punime Betoni					
10	2.166/1 a	FV hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	2.00	42.00	84	10.50
11	1.127/p	Bordura betoni 20x35 cm	ml	450.00	0.90	405	50.63

12	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m ³	84.80	12.80	1,085.44	135.68
13	2.262/4	Shtresë betoni C 16/20	m ³	30.00	8.60	258	32.25
14	3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtresë betoni	ml	15.00	4.40	66	8.25
Shuma Ditë Pune IV							237
Totali Ditë Pune							1,074
Afati i realizimit 2 muaj (44 ditë pune)							24
Staf teknik (4)+Staf teknik mbeshtetes (2)							6
Totali i punonjësve							30.00

Ne lidhje me drejtuesin teknik, së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. **Së dyti**, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”* si dhe pikës 2.1 ku citohet se *“drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

-1 (një) Teknik ndërtimi është i nevojshëm për ndjekjen e punimeve në terren. Ndihmon në mbikëqyrje dhe zbatim në kantier. Harton ditarin e punimeve dhe kontrollon cilësinë e punimeve të betonit, strukturave dhe shtresave të rrugës.

-1 (një) Teknik Topograf është i nevojshëm për realizimin e piketave, trase dhe kontrollin e niveleve gjatë gjithë fazës së ndërtimit dhe përcaktimin e vijave të projektit rrugor, nivelet e shtresave, vendosjen e tombinove, strukturave mbrojtëse etj.

-2 (dy) Karpentier janë të nevojshëm për ndërtimin e kallëpeve për strukturat e betonit (C16/20 dhe

C25/30).Përgatisin kallëpin për themele, mure mbajtëse apo mbrojtëse.

-2 (dy) **Murator** janë të nevojshëm për ndërtimin e strukturave të betonit , mure mbajtëse apo mbrojtëse.

- 8 (tete) **Specialist për punime asfalti** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit(Punimet për shtrimin e shtresave të asfaltit), duhen për shpërndarjen manualisht të asfaltit aty ku makina nuk ka akses të plotë – anësoret, qoshet, hyrje-daljet dhe sigurojnë që temperatura e asfaltit është brenda normave teknike (e rëndësishme për jetëgjatësinë e rrugës).

-2(dy) **Automakinistë** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike për përdorimin e makinave teknologjike .

- 3 (tre) **Manovrator** kërkesa përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike. Përdorimi i mjeteve të rënda si eskavator, fadrome, rula etj.

-1 (një) **Buldozieristë** kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

-3 (tre) **Puntori e thjeshtë** janë të domosdoshëm si pjesë e kantierit dhe kryejnë punë të ndryshme fizike që ndihmojnë në ecurinë e ndërtimit

2.3.6 Operatori/ët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës të certifikuar të paktën

2.3.6/a) 1 (një) punonjes i pajisur me Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë pagesat e shoqërisë të paktën për periudhën e 3 muajve të fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.6/b -1 (nje) punonjes të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listë pagesat e shoqërisë të paktën për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit .

2.3.6/c Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të paraqesë një kontratë pune të vlefshme, licensë për ushtrimin individual të profesionit, diplomë. Në rast se mjeku është i punësuar në shoqëri, duhet të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Në rastin kur mjeku është kontraktuar nga jashtë, do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, licensa përkatëse ,si dhe faturen e këtij shërbimi, sipas VKM-se 632, datë 15.7.2015” Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit

Argumentimi Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr 16/2024 , dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç” VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, dhe mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projekt zbatimin në termat e references, volume të punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit

kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim,inxhiner mjedisi,gjeodet , etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm mbështetës , për të zbatuar kontratën. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projektit si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projektin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar.

Në lidhje me kërkesën për 1 (një) punonjes të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Në lidhje me kërkesën për 1 (një) punonjes të pajisur me Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull mjedisor në kantier . Është e rëndësishme që gjatë punimeve që realizohen, të merren masat për menaxhimin e mbetjeve , si dhe të mbikëqyren zbatimi i masave të mbrojtjes mjedisore referuar punimeve të parashikuara në preventiv Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore mjedisore në fuqi.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat duhet të jenë në pronësi të tij/ qira/ kontrate bashkepunimi , të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës si me poshte:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	3
2.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
3.	Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5- 2 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
4.	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
5.	Eskavator me goma (mjet teknologik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
6.	Fadrome me goma (mjet teknologik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
7.	Minifadrome (mjet teknologik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1

8.	Buldozer	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
9.	Grejder (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
10.	Rimorkiator	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
11.	Autobot Uji	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
12.	Autobetoniere	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
13.	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 10 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
14.	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 18 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
15.	Vibrator Betoni	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
16.	Autobetoniere e me kapacitet mbajtes 2-4 m3(mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
17.	Kontinier Stacioner (zyra, ndrresa)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
18.	Damper me kapacitet mbajtes mbi 30 t (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
19.	Koke terheqese	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
20.	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 3-5 ton	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
21.	Kamion me Vinc	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
22.	Autopompe Betoni	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
23.	Rrul gome-gome	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
24.	Autobitumatrice	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
25.	Asfaltoshtruese	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1
26.	Minidumper me kapacitet mbajtës 2-4 m3(mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	2
27.	Batipal	Ne pronesi, kontrate Qiraje / bashkepunimi	cope	1

Operatori Ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera ose kontrate bashkepunimi
-1 (nje) Pajisje per matjet gjeodezike GPS

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:
Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:

- Çertifikaten e pronesise;
- Leja e qarkullimit;
- Çertifikaten e kontrollit teknik;

- Siguracionin (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;;
- Taksat vjetore të mjetit(e vlefshme)
- Leja e transportit nga njesit e qeverisjes vendore per vete apo per te trete,
- Si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
-

Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e vlefshme e qerave/ bashkëpunimit.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi të vlefshme , krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ Kontrate Bashkëpunimi të vlefshme .

Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme). **Per autobitumatricen** te paraqitet Licence per transport lëndesh të rrezikshme

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe të deklaroj vendodhjen e mjeteve.

Shënim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet kësaj kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të detyrës së projektimit, projektit dhe preventivit .

Mjetet janë përcaktuar sipas nevojës së zbatimit të projektit si më poshtë:

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton
Damper me kapacitet mbajtes mbi 30 t(mjet teknologjik me goma)
Minidumper me kapacitet mbajtës 2-4 m3(mjet teknologjik me goma)

Keta kamiona jane te domosdoshem pasi sipas preventivit kemi punimet zeri 3.222/1, nr. 3.224/1, nr. 3.212/b. Keto mjete bejne te mundur transportin e materialeve nga fabrikat e prodhimit dhe furnizimit drejt kantierit te ndertimit. Jane kerkuar keto mjete me kapacitet te larte pasi sasite jane te konsiderueshme dhe furnizimet e fabrikat e prodhimit jane te largeta ne distance.

Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton
Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton

Keto mjete do te nevojiten per te sjell ne kantier materialet e lehta dhe vegla pune nga me te ndryshme ne kantier,po ashtu do te bejne te mundur dhe transportimin e stafit se bashku me puntoret cdo dite nga kantieri.

Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)
Fadrome me goma
Minifadrome (mjet teknologjik me goma)
Buldozer
Grejder (mjet teknologjik me goma)
Rimorkiator
Koke terheqese

Keto mjete do te sherbejne per kryerjen e germimeve te ndryshme sipas projektit.Po ashtu me keto mjete do te behet hapja dhe sistemimi i cakullit dhe shtresave perkatese sipas projektit, kryhet levizja e materialeve,krijimi i argjinaturave etj... (zerat e preventivit te Punime dheu nga zeri 3.212/b, 3.222/1, 3.224/1 te Shtratit rrugor i gjithe kapitulli, etj... Rimorkiatori duhet per transportin e te gjitha mjeteve te renda si grejder eskavatore, rula, minifadrom, fadrome etj...

Autobot Uji

Ky mjete do te sherbejne per furnizimin ne kantier me uje

Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 10 ton
Autobetoniere
Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 18 ton
Vibrator Betoni
Autobetoniere e me kapacitet mbajtes 2-4 m3(mjet teknologjik me goma)
Autopompe Betoni
Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet 3-5 ton

Keto mjete do te sherbejn per sjelljen e betonit per shtresat e ndryshme te planifikuara ne projekt, per dergimin e betonit ne zona te ndryshme dhe ne lartesi te ndryshme nepermjet autopompes se betonit dhe Vibratori i betonit do te kryej procesin e vibrimit dhe berjen sa me kompakt sipas kushteve teknike betonin e kerkuar ne kantier. Ndersa ruli do te sherbej per ngjeshje e shtresave te ndryshme (stabilizant, binder dhe asfalt) sipas analizave teknike perkatese per zerat: 1.127/p, 3.244, 2.262/4 etj...

GPS
Kontinier Stacioner
Kamion me Vinc

Keto mjete dhe paisje do te perdoren ne kantier per piketime te ndryshme te rruges, per zyre per stafin drejtues dhe teknik , per vendroje, per transportin e materialeve te ndryshme brenda ne kantier etj...

Rrul gome-gome
Autobitumatrice
Asfaltoshtruese
Batipal

Keto mjete jane te nevojshme ne kanter pasi do te kryejne shtrimin e binderit dhe shtrimin e asfaltit. Gjithashtu do te kryhet dhe ngjeshja e ketyre shtresave sipas zerave ne preventive me nr analize: 3.222/1, 3.224/1. Batipali eshte i nevojshem per vendosjen e gurdrailit.

Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkaktuar s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë-deklojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetë-deklarimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me:

➤ Licence e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte".

Argumentimi: Mbeshtetur në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin 16/2024, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në

Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. Nga punimet e ndertimit do te gjenerohen mbetje qe duhen transportuar ne vendepozitim te caktuar nga AK

2.3.9 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

-ISO 9001:2015 mbi "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë" ose ekuivalentin e saj.
ISO 14001:2015 mbi "Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalentin e saj.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standardizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ultë.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme sipas zerave te preventivit te marra persiper.)* Certifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht s'kualifikimi.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Argumentim: Kërkesat janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuara Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato*

janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Argumentimi i specifikimeve teknike : Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesa të autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

- Data e zhvillimit të tenderit do të jetë 26.11.2025 ora 09:00 duke aplikuar shkurtimin me afat 5 ditore në zbatim të nenit 42 pika 5 e ligjit nr.162 "Për prokurimet publike" i ndryshuar referuar nevojave të AK për përshpejtimin e fillimit të punimeve si pasojë e kushteve atmosferike të pafavorshme të stinës së dimrit.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti ose dokumente false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.

ANTARËT E NJËSISË SË PROKURIMIT:

